



RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2023



AUTOR
DHIMITËR ZGURO

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

1. QËNDRIMI I QEVERISË RAMA MBI BASTET	3
2. PROJEKTLIGJI PËR RIKTHIMIN E BASTEVE SPORTIVE	5
2.1 Kriteret (jo) të forta për licencimin e subjekteve	5
2.2 Aspekti social i projektligjit	7
3. FATI I ATYRE QË FATIN E LANË NË LOJËRA	9
3.1 Të dhënat statistikore	10
3.2 (Pa)parashikueshmëria e ndryshimeve ligjore dhe ndikimi në dramën sociale.....	11
REKOMANDIME	14
BIBLIOGRAFIA	15



1. QËNDRIMI I QEVERISË RAMA MBI BASTET

Më datë 14 tetor 2013, pas një muaji nga ardhja në pushtet e qeverisë “Rama”, Policia e Shtetit, e drejtuar nga Artan Didi filloi operacionin policor “Fundi i marrëzisë”, i cili kishte për synim goditjen e kundërligjshmërisë në lojërat e fatit. Sipas raportimit publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme (aktualisht Ministria e Brendshme dhe në vijim referuar si “MB”), të drejtuar asokohe nga Saimir Tahiri, ky ishte një nga operacionet më të suksesshme policore që rezultoi në: (i) kontrollimin në shkallë vendi të 1553 subjekteve; (ii) evidentimin e 720 veprave penale “Zhvillim i palejuar i lojërave të fatit” dhe kallëzimin për ndjekje penale për 714 shtetas; (iii) sekuestrimin e 3710 pajisjeve të lojërave të fatit, 291 kompjuterave dhe 718 televizorëve, pajisje të cilat kishin një vlerë totale prej 8.5 milion EUR.¹

Në vitin 2015, Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave, vendosi miratimin e ligjit nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji për lojërat e fatit”). Sipas Relacionit shpjegues, qëllimi i këtij ligji ishte reformimi i kuadrit ligjor në fushën e lojërave të fatit për shkak jo vetëm të informalitetit të lartë, evazionit fiskal, por edhe për shkak të pasojave sociale negative të kategoritë e prekura dhe qytetarët.² Mbrojtja e këtyre të fundit sipas parimit “lojë me përgjegjshmëri”, duke reduktuar ndikimin negativ që sillte ky lloj aktiviteti tek qytetarët, ishte po ashtu një ndër qëllimet e ligjit të miratuar nga mazhoranca. Megjithëse në Relacionin shpjegues të projektligjit parashikohej se numri maksimal i basteve sportive do të ishte 500 salla, me një distancë jo më pak se 200 metra larg njëra pikë nga tjetra,³ Kuvendi, me propozimin e dy deputetëve, vendosi të amendojë projektligjin duke përcaktuar se bastet sportive do të kishin deri në 1000 salla, dhe distanca nga njëra pikë tek tjetra duhet të ishte jo më pak se 100 metra.⁴

Më 9 tetor 2018, gjatë një konference për shtyp, Kryeministri njoftoi ndryshimin e ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” duke ndaluar përfundimisht kazinotë elektronike dhe bastet sportive. Kjo konferencë i parapriu një fushate mediatike të Kryeministrit, i cili i cilësoi bastet sportive si një “mortje që është kudo” dhe që çdo formë e tyre, përfshi dhe bastet online, do të ndalohej nga

¹ Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit: *Prezantim i reformave ligjore e institucionale*. Për më shumë shih: <https://mb.gov.al/raportimi-publik-i-mpb-per-300-ditet-e-para-te-qeverisies/>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

² Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”*. Për më shumë shih: https://web-api.parlament.al/Files/relacion_lojerat_e_fatit_21020_1.pdf, aksesuar online më datë 16.10.2023.

³ Po aty.

⁴ Ligj nr. 155/2015, datë 21.12.2015, FZ Nr. 251, datë 31.12.2015.



nisma e qeverisë.⁵ Tre ditë më pas, më datë 12 tetor, Këshilli i Ministrave depozitoi pranë Kuvendit projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015, ‘Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, në të cilin përcaktohej se: “Organizatorët e kategorive ‘Baste sportive’ dhe ‘Baste për garat në pistë’, do të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018.” Ndërsa Kryeministri, gjatë një interviste, deklaronte se “(...) pas 31 dhjetorit, do shihet mundësia që [bastet] të lejohen (on line) nëpërmjet garës”,⁶ në Relacionin shpjegues përcaktohej se për vazhdimin e kësaj veprimtarie, po shqyrtohej mundësia e trajtimit të saj si monopol shtetëror duke bërë që kjo veprimtari të ushtrohej vetëm nga struktura shtetërore të ngritura posaçërisht për këtë qëllim.⁷ Ky projektligj u miratua, me procedurë të përshpejtuar, më datë 25 tetor 2018.

Thuajse dy vite pas miratimit të ligjit nr. 75/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, ‘Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, Fidel Ylli, atëbotë deputet i Partisë Socialiste, filloi një fushatë që kishte për synim rikthimin e basteve sportive.⁸ Kjo fushatë u intensifikua me zgjedhjen e Fidel Yllit në krye të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, i cili propozoi që të ardhurat e grumbulluara nga bastet sportive të kalojnë për llogari të zhvillimit të sportit.⁹

Në vijim të kësaj fushate, më 31.08.2022, gjatë një dëgjese publike me federatat e sportit, Edi Rama paralajmëroi rikthimin e basteve sportive online, duke argumentuar se aktiviteti i zhvilluar në të zezë nga elementët kriminalë nuk mund të bllokohet dhe deklaruar se me nismën e re legislative, do të mbrohet edhe konsumatori.¹⁰



⁵Për më shumë shih: <https://www.balkanweb.com/bastet-rama-i-prere-nje-mortje-qe-jane-kudo-ja-ku-do-i-Hejojme/>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

⁶ Për më shumë shih: <https://www.balkanweb.com/bastet-rama-i-prere-nje-mortje-qe-jane-kudo-ja-ku-do-i-Hejojme/>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

⁷ Kuvendi i Shqipërisë, Relacion për projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 ‘Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”. Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/20181018101402RELACION%20-%20SHITESE%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

⁸ Për më shumë shih: <https://gazetamapo.al/fidel-ylli-thirrje-rames-rikthe-bastet-sportive-as-enver-hoxha-nuk-i-ndaloj/>, aksesuar online më datë 17.10.2023.

⁹ Për më shumë shih: <https://albanianpost.com/fidel-ylli-bastet-sportive-duhet-te-hapen/>, aksesuar online më datë 16.10.2023; <https://www.gazetatema.net/sport/fidel-ylli-bastet-si-mbylli-dot-enver-hoxha-jo-me-edi-rama-i337393>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

¹⁰ Për më shumë shih: <https://www.reporter.al/2022/08/31/rama-paralajmëron-rikthimin-e-basteve-online/>, aksesuar online më datë 18.10.2023.

2. PROJEKTLIGJI PËR RIKTHIMIN E BASTEVE SPORTIVE

Më datë 21.07.2023, Këshilli i Ministrave depozitoi pranë Kuvendit të Shqipërisë projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë'".¹¹ Sipas Relacionit të projektligjit, qëllimet kryesore të këtij projektligji janë dy: së pari, rikthimi i kategorisë së basteve sportive në formën online, me qëllim formalizimin e tregut të lojërave të fatit, duke licencuar subjekte me eksperiencë në këtë aktivitet; dhe së dyti, garantimin për përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga bastet sportive on-line në mbështetjen direkte për fushën e sportit, kulturës, inovacionit dhe teknologjisë së inovacionit.¹²

2.1 Kriteret (jo) të forta për licencimin e subjekteve

Një nga shkaqet e ndalimit të basteve sportive ishte dhe fakti se subjektet që ushtronin veprimtari në këtë fushë ishin të lidhura me krimin, duke u financuar prej tij dhe duke u përdorur për pastrimin e parave.¹³

Me qëllim për t'ju shmangur një situatë të tillë, në projektligj, parashikohet rishikimi i mënyrës së licencimit duke përcaktuar, sipas vetë Relacionit, kriteret më të forta për organizatorët e lojërave të fatit.¹⁴ Kështu në nenin 22, propozohet të përcaktohen kriteret që lidhen me licencimin e basteve sportive on-line. Sipas këtij neni, që një person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, të pajiset me licencë në kategorinë e basteve sportive online, duhet që të përmbushë, ndër të tjera, edhe këto kushte: (i) të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit në më pak se jo tre shtete të BE/OECD dhe jo për më pak se 3 vjet, ose këtë kriter ta përmbushë njëri prej aksionarëve; (ii) të ketë gjeneruar në vitin e fundit financiar të paktën dy miliardë lekë nga aktiviteti në fushën e lojërave të fatit, ose këtë kriter ta përmbushë njëri prej aksionarëve.¹⁵

¹¹ Për më shumë shih: <https://parlament.al/dokumentacioni/aktet/1b8aa6c1-56a9-48a9-a20b-c91b6185f854>, aksesuar online më datë 18.10.2023.

¹² Kuvendi i Shqipërisë, Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar". Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078642SHTESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

¹³ Për më shumë shih: <https://top-channel.tv/2018/10/22/rama-bixhozi-financohet-nga-krimi-perdoret-per-pastrim-parash/>, aksesuar online më datë 17.10.2023.

¹⁴ Kuvendi i Shqipërisë, Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar". Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078481RELACION%20-%20SHTESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

¹⁵ Po aty.



Pra që një subjekt të mund të licencohet në Shqipëri për të vepruar në kategorinë e basteve sportive online duhet që ai të jetë ose një subjekt i licencuar në të paktën tre vende të BE-së apo OECD-së, ose njëri prej aksionarëve të përmbushë këtë kusht. E njëjta gjë vlen dhe përsa i takon të ardhurave të gjeneruara në vitin financiar.

Së pari, kërkesa që së paku, në mos subjekti që kërkon të licencohet, njëri prej aksionarëve të subjektit kërkues të ketë eksperiencë në fushën e lojërave të fatit në më pak se jo tre shtete të BE/OECD-së, është një kriter që rrezikon të jetë thjesht formal në kushtet kur nuk ka asnjë parashikim ligjor mbi përqindjen minimale të aksioneve që duhet të zotërojë në kapitalin e shoqërisë ky aksionar. Fakti që ky kriter rrezikon të mbetet një kriter formal lidhet me faktin se sipas variantit aktual të projektligjit, ky kriter konsiderohet i përmbushur dhe në ato raste, kur aksionari me përvojë në tre shtete të BE/OECD-së zotëron 1% të aksioneve të kapitalit në shoqëri.

Në të tilla kushte, ky kriter i vendosur me qëllim formalizimin e tregut dhe pengimin e subjekteve të lidhura me krimin për të depërtuar në këtë aktivitet fitimprurës, është thjesht një kriter formal, i cili mund të plotësohet duke e lënë sërish ushtrimin e aktivitetit në dorën e subjekteve të lidhura me krimin, të cilat mund të zotërojnë shumicën e aksioneve të kapitalit.

Së dyti, projektligji i depozituar në Kuvend nuk parashikon asnjë sanksion se çfarë ndodh në ato raste kur subjekti i huaj, i licencuar në të paktën tre shtete të Bashkimit Evropian apo OECD-së, vendos të largohet nga shoqëria duke i transferuar kuotat tek një prej aksionerëve apo tek një palë e tretë që nuk përmbush kushtin e përvojës.

Duke mos parashikuar asnjë sanksion si pezullimi i licencës deri në gjetjen e një aksionari tjetër, që të plotësojë kushtin e përvojës apo të revokimit të licencës, në rastin e largimit të këtij aksionari dhe mos zëvendësimit të tij brenda një afati të arsyeshëm, projektligji lejon që pas licencimit subjektet të vijojnë veprimtarinë normalisht, edhe nëse nuk e plotësojnë më kushtin e përvojës, kusht të cilin, projektligji e lidh ekskluzivisht me momentin e marrjes së licencës.

Nën të njëjtën linjë arsyetimi, problematika shfaqet dhe në drejtim të largimit të aksionarit që plotëson kriterin financiar të xhiros vjetore. Projektligji duke e lidhur këtë kriter në mënyrë ekskluzive vetëm me momentin e marrjes së licencës, lejon që veprimtaria e një subjekti të vijojë në mënyrë normale, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, edhe në



ato raste kur subjekti, pas licencimit, nuk arrin ta plotësojë më këtë kusht sepse njëri prej aksionarëve është larguar nga shoqëria.¹⁶ Kjo vendos në rrezik si garancitë që ofrohen për mbrojtjen e konsumatorit, por edhe vetë autoritetet shtetërore.

Po ashtu, një tjetër aspekt që paraqitet mjaft problematik lidhet me faktin se projektligji nuk ndalon që aksionarë të një shoqërie të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të jetë e regjistruar në një parajsë fiskale.¹⁷

Duke mbajtur në konsideratë, se mos përcaktimi i një përqindjeje minimale përsa i takon pronësisë mbi aksionet e kapitalit, rrezikon së tepërmi, që pjesë e tregut të basteve sportive online të jenë pjesë dhe shoqëritë offshore. Këto të fundit, në rast se zotërojnë më pak se 25% të aksioneve të kapitalit, në bazë të ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”,¹⁸ nuk janë të detyruara të deklarojnë pronarët fundorë dhe për rrjedhojë, rreziku që këto shoqëri të administrohen apo të jenë nën pronësi të subjekteve të lidhura me krimin apo politikën, është mjaft i lartë.

Po ashtu, edhe sikur të përcaktohej përqindja minimale përsa i takon pronësisë mbi aksionet e kapitalit, sërish shoqëritë offshore duhet të përjashtohen nga e drejta për t’u pajisur me licencë për kategorinë e basteve sportive online. Kjo për shkak se duke përdorur mënyra të copëzimit të aksioneve në shtetin ku këto shoqëri janë të regjistruara, ato mund t’i shmangen lehtësisht detyrimit për të raportuar pronarët përfitues dhe për rrjedhojë, në zbatim të ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues” dhe vendimit nr. 1088, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara”, të Këshillit të Ministrave, duhet të raportojnë si pronar përfitues individin që mban pozicionin e drejtuesit më të lartë të subjektit raportues.¹⁹

2.2 Aspekti social i projektligjit

Sikundërse është trajtuar dhe më herët gjatë këtij punimi, Kryeministri dhe qeveria i cilësuan bastet sportive si një plagë sociale. Në raportin

¹⁶ Kuvendi i Shqipërisë, Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 ‘Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”. Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078642SHITESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>, aksesuar online më datë 16.10.2023.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Ligj nr. 112/2020, datë 29.07.2020, FZ Nr. 112, datë 13.08.2020.

¹⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1088, datë 24.12.2020, FZ Nr. 233, datë 30.12.2020.



për dhënie mendime të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, relatori i projektligjit shprehej se:

“Modeli i biznesit të kësaj kategori loje nuk rezulton me vlerë të shtuar për shoqërinë, por përkundrazi zgjerimi i këtij aktiviteti në treg sjell rrezik potencial për varfërimin e ekonomisë familjare dhe krijimin e dramave sociale.”²⁰

Pasojat e rënda sociale, sikundërse e ka pranuar dhe vetë Këshilli i Ministrave në relacionin e projektligjit të paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë që synon rikthimin e basteve sportive online, nuk janë ndalur me ndalimin kategorik të basteve sportive, por janë thelluar pasi informaliteti i krijuar, siç do të analizohet në vijim, ka sjellë që shumë shtetas të dënohen penalisht.

Megjithëse është e vërtetë se masa e ndalimit të basteve kategorike nuk do të mund ta ndalonte fenomenin e basteve, sikurse është e vërtetë që ndalimi i këtij fenomeni është thuajse i pamundur, shteti duhet të marrë përgjegjësi të tilla që të zbusin sa më shumë të jetë e mundur pasojat sociale të fenomenit të basteve.

Me qëllim evitimin e të njëjtës dramë sociale, që shërbeu për ndalimin e basteve sportive, dhe për t'i shërbyer vetë qëllimit të projektligjit, ky i fundit duhet të parashikonte një kufi maksimal të shumave që mund të luhen në bastet sportive nga kategori të caktuara sociale, veçanërisht nga ato subjekte që kanë krijuar varësi ndaj basteve. Ky kufi maksimal mund të përcaktohej në baza mujore, dhe në rast të arritjes së vlerës së parashikuar si kufi maksimal për të luajtur subjektin i duhej refuzuar luajtja në bastet sportive. Me qëllim që dhe subjektet e licencuara të nxiteshin në zbatim të këtyre ndalimeve, ndaj tyre mund të aplikoheshin sanksione administrative të llojit gjobë në rast të konstatimit se kanë lejuar që një subjekt të luajë në tejkalim të vlerës kufi.

Një tjetër aspekt me rëndësi është parashikimi ligjor që përcakton se të ardhurat e përfituara nga zbatimi i ligjit shërbejnë për krijimin e një fondi të posaçëm që do të shërbejë për mbështetjen e projekteve në fushën e sportit, kulturës, inovacionit dhe teknologjisë së inovacionit. Në gjykimin tonë, megjithëse ky është vetë një nga qëllimet e ligjit, në kuadër të rikthimit të basteve sportive, në formën online, projektligji

²⁰ Kuvendi i Shqipërisë, Raport “Për projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 ‘Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”. Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/20181024123934Raport%20i%20Komisionit%20p%C3%ABr%20Ekonomin%C3%AB%20dhe%20Financat.pdf>, aksesuar online më datë 24.10.2023.



duhet të mbante në konsideratë dhe rrezikun e krijimit të dramave sociale. Me qëllim jo vetëm parandalimin e një drame tjetër sociale, por edhe të shërimit të saj, gjykojmë se do të ishte e nevojshme që një pjesë e fondit të posaçëm që do të krijohej nga zbatimi i ligjit të dedikohej për ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit për të gjithë personat që kanë krijuar varësi ndaj basteve sportive apo viktimave të këtij fenomeni.

3. FATI I ATYRE QË FATIN E LANË NË LOJËRA

Më datë 02.05.2019, Këshilli i Ministrave depozitoi në Kuvend nismën legislative për ndryshimin e Kodit Penal, duke përfshirë në këto ndryshime dhe nenin 197, të Kodit Penal, që lidhej me organizimin e llotarive të palejuara. Deri më hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, në nenin 197, të Kodit Penal përcaktohej se:

“Organizmi i llotarive, lojrave të fatit apo bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.”²¹

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2019, përmbajtja e këtij neni u bë si vijon:

“Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë.”²²

Ndryshimet ligjore të ligjit për lojërat e fatit, të shoqëruara me ndryshimin e legjislacionit penal, në të cilin u zgjerua ana objektive, pra veprimet apo mosveprimet të cilat do të konsideroheshin si të kundërligjshme, e veprës penale të parashikuar në nenin 197, të Kodit Penal, solli rritjen e numrit të të proceduarve penalisht, si dhe numrin e

²¹ Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995, FZ Nr. 2, datë 16.03.1995.


²² Ligj nr. 44/2019, datë 18.07.2019, FZ Nr. 131, datë 24.09.2019.



të dënuarve. Ky fakt përbën një nga pasojat sociale më të mëdha që solli ndalimi i basteve sportive.

3.1 Të dhënat statistikore

Sipas Raporteve të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në vend, përgjatë vitit 2022, është vërejtur rritje e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të “Organizimit ose ushtrimit të veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, të parashikuar në nenin 197, të Kodit Penal, me 24,63% në krahasim me vitin 2021.²³ Ndërsa përgjatë vitit 2021, procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale u rritën me 66,34% në krahasim me vitin 2020.²⁴



Tab. 1. Të dhëna statistikore për veprën penale të “Organizimit ose ushtrimit të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, të parashikuar në nenin 197, të Kodit Penal.²⁵

Nga grafiku i mësipërm, shihet qartë se viti 2022 shënoi një rritje si të numrit të procedimeve të regjistruara, si të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë, ashtu edhe të numrit të të pandehurve, si të atyre të regjistruar, ashtu edhe të atyre të cilët janë dërguar për gjykim në gjykatë. Në këtë linjë logjike, është rritur dhe numri i të pandehurve të dënuar. Kështu ndërsa në vitin 2021 janë dënuar vetëm 65 të pandehur, për vitin 2022, janë dënuar 151 të pandehur. Rritja e numrit të të dënuarve nga viti 2021 në vitin 2022, është një rritje sinjifikative dhe

²³ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raport “Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2022”. Për më shumë shih:

https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_691_5.pdf, aksesuar online më datë 25.10.2023.

²⁴ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raport “Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021”. Për më shumë shih:


https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_Kuvendit_per_Kriminalitetin_2021_31_03_22_PP_6411.pdf, aksesuar online më datë 25.10.2023.

²⁵ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raporte mbi gjendjen e kriminalitetit. Për më shumë shih: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_I_PROKURORIT_I_P_RGJITHSH_M/, aksesuar online më datë 25.10.2023.



mjaft e lartë, po të mbahet në konsideratë se gjatë vitit 2020 numri i të dënuarve për këtë vepër penale ishte vetëm 45.

Përsa i takon masës së dënimit, vlen të theksojmë se në vitin 2021, në 77,27% të çështjeve penale ka kërkuar aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë të të dënuarit. Kjo shifër paraqitet më e ulët se në vitin 2022, gjatë të cilit, prokuroria kërkoj aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë të të pandehurit në 82,9% të çështjeve penale. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në prove për 92,1% të të pandehurve në vitin 2022, ndërsa në vitin 2021, vetëm për 83,08% të të pandehurve.



Tab. 2. Të dhëna statistikore mbi masën e dënimit për veprën penale të “Organizimit ose ushtrimit të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, të parashikuar në nenin 197, të Kodit Penal.²⁶

3.2 (Pa)parashikueshmëria e ndryshimeve ligjore dhe ndikimi në dramën sociale

Neni 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton parimin e shtetit të së drejtës, i cili është dhe një nga parimet themelore në shtetet dhe shoqëritë demokratike. Një nga aspektet e këtij parimi është dhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe pritshmëria legjitime.²⁷ Sipas Gjykatës Kushtetuese:

“Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose

²⁶ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raporte mbi gjendjen e kriminalitetit. Për më shumë shih: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/, aksesuar online më datë 25.10.2023.

²⁷ Vendimi nr. 1, datë 16.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese.



profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme."²⁸

Po ashtu, sipas Gjykatës Kushtetuese, parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin të sistemi juridik.²⁹ Duke mbajtur në konsideratë këtë interpretim të parimit të sigurisë juridike, ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit, veçanërisht i atij që përdoret si legjislacion referues për përcaktimin e sjelljeve në të kundërligjshme apo jo, duhet të mos ndodhë për aq kohë sa nuk ka shkaqe të rëndësishme që e përligjin këtë ndryshim.

Në rastin konkret, ndryshimi i legjislacionit, tanimë, duke lejuar bastet sportive online, pasi me qindra qytetarë shqiptarë janë proceduar penalisht, hetuar dhe dënuar, në gjykimin tonë, mund të përbëjë shkak për të pretenduar cënimin e parimit të sigurisë juridike, sepse për shkak të mosqëndrueshmërisë së legjislacionit dhe ndryshimit të tij të shpeshtë duke i lejuar fillimisht bastet sportive, më pas duke i ndaluar dhe në fund, duke i rikthyer dhe lejuar ato, ka sjellë dënimin penal të individëve.

Por nëse përsa më sipër cënueshmëria e sigurisë juridike mund të vihet në pikëpyetje, është e padiskutueshme se ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit ka krijuar një dramë më të madhe sociale, si ajo e dënimit penal të individëve, të cilët edhe në referim të Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, në shumicën e rasteve kanë qenë të padënuar më herët.³⁰

Dënimi penal i këtyre individëve megjithëse mund të mos ketë rritur kostot në Buxhetin e Shtetit përsa i takon shpenzimeve që lidhen me të burgosurit, duke qenë se sikundër është trajtuar dhe më herët, në shumicën e çështjeve masa e dënimit të aplikuar ka qenë pezullimi i dënimit dhe vënia në provë e të dënuarit, ka rënduar sistemin e gjyqësorit dhe prokurorisë duke mos lejuar që politika penale të fokusohet drejt çështjeve penale me më shumë rëndësi dhe krimeve të rënda, por dhe drejt veprimeve të tilla si organizimi apo ushtrimi i lojërave të fatit, të cilat nuk paraqesin një rrezikshmëri shoqërore të lartë në krahasim me vepra të tjera, të parashikuara në Kodin Penal.

²⁸ Vendimi nr. 31, datë 18.06.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

²⁹ Vendimi nr. 15, datë 10.03.2016 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 25, datë 28.04.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁰ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, *Raporte mbi gjendjen e kriminalitetit*. Për më shumë shih: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_I_P_PROKURORIT_I_P_RGJITHSH_M/, aksesuar online më datë 25.10.2023.



Nga ana tjetër, qytetarët e dënuar tashmë, do të vuajnë pasojat e dënimit të tyre megjithë ndryshimin që do të pësojë legjislacioni i lojërave të fatit. Kjo për shkak se në momentin që vendimi i dënimit merr formë të prerë, në zbatim të nenit 482, të Kodit të Procedurës Penale, ai shënohet në regjistrin gjyqësor që pasqyron gjendjen gjyqësore të personave të gjykuar penalisht. Amnistia, e premtuar publikisht nga Ministri i Drejtësisë Z. Manja, e cila sipas draftit të publikuar do të përjashtojë nga vuajtja e dënimit të gjithë të dënuarit për veprën penale të “Organizimit ose ushtrimit të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, të parashikuar nga paragrafi i parë, ose në rast se këtyre të dënuarve u ka mbetur për të vuajtur jo më shumë se tre vite,³¹ nuk mund t’i rehabilitojë të dënuarit, pa u plotësuar afati i përfitimit, që përlllogaritet sipas nenit 69, të Kodit Penal.³² Dhe derisa ky afat të plotësohet, të gjithë të dënuarit, që me amnisti do të përjashtohen nga vuajtja e dënimit, do të duhet të vuajnë pasojat e dënimit penal në kurriz të tyre, dhe për rrjedhojë, edhe integrimi i tyre në shoqëri do të jetë më i vështirë.



³¹ Kuvendi i Shqipërisë, *Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"*. Për më shumë shih: <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078642SHTESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>.

³² Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995, FZ Nr. 2, datë 16.03.1995.

REKOMANDIME

Në kuadër të analizës së mësipërme, dhe veçanërisht të analizës mbi pasojat që prodhohen në shoqëri nga miratimi i ndryshimeve ligjore, në mënyrë të shpeshtë, vlen të theksojmë se, së pari, Kuvendi i Shqipërisë, si organi ligjvënës dhe Këshilli i Ministrave, si një nga propozuesit kryesorë të nismave ligjvënëse, duhet që, në çdo rast, të mbajnë në konsideratë pasojat që mund të vijnë si pasojë e këtyre ndryshimeve ligjore, veçanërisht kur këto ndryshime ndikojnë në përmbajtjen e dispozitave juridiko-penale. Përndryshe, politika penale nuk mund të jetë asgjë tjetër veçse një lojë fati.

Së dyti, nisma për rikthimin e basteve sportive është një nismë që, në këndvështrimin e autorit të këtij punimi, meriton të vlerësohet, veçanërisht, në kushtet kur ajo synon të formalizojë tregun. Megjithatë, projektligji në vetvete, sikundër kemi parashtruar përgjatë këtij punimi, paraqitet problematik në drejtim të përmbushjes së misionit të tij. Me qëllim adresimin e problematikave, është e nevojshme që jo vetëm ligjvënësi të përcaktojë një përqaqndje minimale mbi aksionet e kapitalit të aksionarit që gëzon përvojë në të paktën 3 shtete të BE-së apo OECD-së, por edhe të parashikojë sanksione të tilla si humbja e licencës, në rast se aksionari vendos të transferojë kuotat tek një subjekt i tretë, që nuk plotëson kriterin e përvojës.

Së treti, me qëllim për të shmangur një situatë të ngjashme, me atë që sipas Kryeministrit shërbeu si arsye për ndalimin e basteve sportive, pra me kapjen e këtyre subjekteve nga krimi apo pastrimin e parave përmes tyre, ligjvënësi duhet të ndalojë që subjektet e regjistruara në off-shore, të mund të kenë të drejtën për të përfituar një nga licencat për ushtrimin e basteve sportive.



BIBLIOGRAFIA

- "Fidel Ylli: Bastet sportive duhet të hapen." *Albanian Post*, 22 Prill 2021, <https://albanianpost.com/fidel-ylli-bastet-sportive-duhet-te-hapen/>;
- "Fidel Ylli thirrje Ramës: Rikthe bastet sportive, as Enver Hoxha nuk i ndaloi." *Gazeta Mapo*, 30 Janar 2021, <https://gazetamapo.al/fidel-ylli-thirrje-rames-rikthe-bastet-sportive-as-enver-hoxha-nuk-i-ndaloi/>;
- "Fidel Ylli: Bastet s'i mbylli dot Enver Hoxha, jo më Edi Rama!" *Gazeta Tema*, 7 Maj 2022, <https://www.gazetatema.net/sport/fidel-ylli-bastet-si-mbylli-dot-enver-hoxha-jo-me-edi-rama-i337393>;
- "Rama paralajmëron rikthimin e basteve online." *Reporter.al*, 31 Gusht 2022, <https://www.reporter.al/2022/08/31/rama-paralajmëron-rikthimin-e-basteve-online/>;
- "Rama: Bixhozi finançohet nga krimi, përdoret për pastrim parash!" *Top Channel*, 22 Tetor 2018, <https://top-channel.tv/2018/10/22/rama-bixhozi-financohet-nga-krimi-perdoret-per-pastrim-parash/>;
- "INTERVISTA/ Rama i prerë për bastet: Një mortje që janë kudo." *Balkanweb*, 16 Tetor 2018, <https://www.balkanweb.com/bastet-rama-i-prere-nje-mortje-qe-jane-kudo-ja-ku-do-i-lejojme/>;
- Kuvendi i Shqipërisë. <https://parlament.al/dokumentacioni/aktet/1b8aa6c1-56a9-48a9-a20b-c91b6185f854>;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"*. <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078642SHTESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Raport "Për projektligjin "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"*. <https://web-api.parlament.al/Files/20181024123934Raport%20i%20Komisionit%20p%C3%ABr%20Ekonomi%C3%ABdhe%20Financat.pdf>;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"*. <https://web-api.parlament.al/Files/202308281542078481RELACION%20-%20SHTESA%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë"*. https://web-api.parlament.al/Files/relacion_lojerat_e_fatit_21020_1.pdf;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 'Për lojërat e fatit në*



Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar". <https://web-api.parlament.al/Files/20181018101402RELACION%20-%20SHTESE%20155%20-%20LOJERAT%20E%20FATIT.pdf>.

- Ligj nr. 112/2020, datë 29.07.2020, FZ Nr. 112, datë 13.08.2020;
- Ligj nr. 155/2015, datë 21.12.2015, FZ Nr. 251, datë 31.12.2015;
- Ligj nr. 44/2019, datë 18.07.2019, FZ Nr. 131, datë 24.09.2019;
- Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995, FZ Nr. 2, datë 16.03.1995;
- Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995, FZ Nr. 2, datë 16.03.1995;
- Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit: Prezantim i reformave ligjore e institucionale. <https://mb.gov.al/raportimi-publik-i-mpb-per-300-ditet-e-para-te-qeverisjes/>;
- Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raport "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2022". https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_6915.pdf;
- Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raport "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021". https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_Kuvendit_per_Kriminalitetin_2021_31_03_22_PP_6411.pdf;
- Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Raporte mbi gjendjen e kriminalitetit. https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1088, datë 24.12.2020, FZ Nr. 233, datë 30.12.2020;
- Vendimi nr. 1, datë 16.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 15, datë 10.03.2016 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 25, datë 28.04.2014 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 31, datë 18.06.2010 i Gjykatës Kushtetuese.



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al